

Marrëveshje Transferimi të Pjesëve të Kapitalit

Në Tiranë, më datë 24/05/2025 nënshkruhet kjo marrëveshje kalimi kuotash mes palevë të mëposhtëme:

Shitësi :

Z. Angelos Ago shtetas shqiptar, lindur më 10.09.1996, në Cangonj, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me numër 032969516 dhe me numër personal J60910035P madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e ortakut që zotëron 1 pjesë me vlerë 300,000 lekë që përbën 30% të kapitalit të shoqërisë **BORRETTO TECH** sh.p.k. shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar me nipt **M51426035P** themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar rregullisht në Qendrën Kombëtare Shqiptare të Regjistrimit (OKB) me seli në Tiranë, Rruga Nacionale, Autostrada Tiranë - Elbasan, Tirana East Bus Terminal, kati i pare TEG, kodi 1045.

Shitësi deklaron që 30% të kuotave të kapitalit të tij do ta trasferoj tek palët blerëse, përkatësisht 15% tek oratku Z. Ilirik Dulo dhe 15% tek Z. Leonis Tahiraj.

Blerësi:

Z. Ilirik Dulo lindur më 10.07.1976 në Cangonj, Shqipëri mbajtës i kartës së identitetit me numër 034548918 dhe numër personal H60710035H, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e ortakut që zotëron 40% të kapitalit të Shoqërisë **BORRETTO** sh.p.k. dhe së bashku me blerjen e 15% të kuotave të kapitalit, do të përfaqësoj 1 kuotë e cila përbën 55% të kapitalit të shoqërisë.

Blerësi:

Z. Leonis Tahiraj lindur më 04.02.1996 në Berat, Shqipëri mbajtës i Pasapotës me numër BI2654648 dhe numër personal J60204002L, madhor me zotësi të plotë për të vepruar në cilësinë e ortakut që zotëron 30% të kapitalit të Shoqërisë **BORRETTO** sh.p.k. dhe së bashku me blerjen e 15% të kuotave të kapitalit, do të përfaqësoj 1 kuotë e cila përbën 45% të kapitalit të shoqërisë.

MEQËNËSE:

Z. Angelos Ago zotëron një kuotë që përfaqëson 30% të Kapitalit të Shoqërisë **BORRETTO** Sh.p.k. një shoqëri ekzistuese sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar më datë 26.02.2025, me seli në Tiranë, Autostrada Tiranë - Elbasan, Tirana East Bus Terminal, kati i pare TEG, kodi 1045, Shqipëri me një kapital prej 1,000,000 lekë.



- A. Shitësi **Z. Angelos Ago** dëshiron të transferojë 30% të kapitalit të zotëruara prej tij në shoqërinë **BORRETTO sh.p.k**, përkatësisht 15% të kapitalit të shoqërisë tek Blerësi Ortaku **Z. Ilirik Dulo**, dhe 15% tek ortaku tjetër **Z. Leonis Tahiraj**.
- B. Blerësi **Z. Ilirik Dulo** dëshiron të blejë 15% të kapitalit të kësaj shoqërie që aktualisht është në pronësi të Shitësit, **Z. Angelos Ago**.
- C. Blerësi **Z. Leonis Tahiraj** dëshiron të blejë 15% të kapitalit të kësaj shoqërie që aktualisht është në pronësi të Shitësit, **Z. Angelos Ago**.
- D. Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Nenet e Statutit të Shoqërisë, asambleja e ortakevë të shoqërisë ka vendosur lidhur me këtë transferim, sipas vendimit bashkangjitur kësaj marrëveshjeje

Për sa më sipër palët bien dakort si më poshtë:

1. **Shitësi** deklaron se ka marrë nga Blerësi në mënyrë të plotë të gjithë çmimin e blerjes të rënë dakord prej 150,000 Lekë dhe për këtë arsye transferon këtu 15% të kapitalit në pronësi të berësit **Z. Ilirik Dulo**, si dhe ka marrë nga blerësi 150,000 Lekë dhe për këtë arsye transferon këtu 15% të kapitalit në pronësi të blerësit **Z. Leonis Tahiraj**, të cilat përkojnë me 30% të zotëruar prej tij në Kapitalin e Shoqërisë **BORRETTO sh.p.k**. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësit se pjesa e kapitalit të transferuar këtu, është në pronësinë e tij të plotë e ligjore dhe është i lirë nga barra, hipoteke apo pengje.

Nga ky moment **Z. Ilirik Dulo** do të jetë pronar i 55% të kapitalit i cili përbën 1 (një) kuotë dhe **Z. Leonis Tahiraj** do të jetë pronar i 45% të kapitalit i cili përbën 1 (një) kuotë në shoqërinë **BORRETTO sh.p.k**.

2. Blerësi **Z. Ilirik Dulo** pranon blerjen e 15% të kapitalit dhe së bashku 40% të vlerës së kapitalit që zotëronte shkon në 55% pronësi të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjëndjen e Shoqërisë dhe bie dakort me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre kuotës brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
3. Blerësi **Z. Leonis Tahiraj** pranon blerjen e 15% të kapitalit dhe së bashku 30% të vlerës së kapitalit që zotëronte shkon në 45% pronësi të kapitalit të shoqërisë, duke njohur gjëndjen e Shoqërisë dhe bie dakort me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i këtyre kuotës brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.



4. Shitësi dhe Blerësit bien dakort të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e transferimit të këtyre Kuotave objekt të kësaj Marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Marrëveshje u nënshkrua me vullnet të lirë nga në palët në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Marrëveshja bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Nr. 9901, date 14.04.2008 dhe Statutit të Shoqërisë

SHITËSI : Angelos Ago

Angelos Ago

BLERËSI: Ilir Dulo

Ilir Dulo

BLERËSI: Leonis Tahiraj

Leonis Tahiraj

